



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 09/11

Prishtinë, më 13.04.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Hasime Krasniqi, Albana Fetoshi, Muhamet Mustafa, Duda Balje dhe Xhevdet Neziraj

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Rahman Paçarizi dhe Sylejman Shaqiri nga RTK, Hasan Preteni nga AKK, Ahmet Tmava dhe Azem Rexhaj nga KMM, Raif Preteni dhe Ramiz Krasniqi nga ZRRUM, Teki Shala dhe Njomza Ilazi nga GIZ, si dhe monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimin e propozimit të Panelit të Bordit të Bankës Qendrore për zgjedhjen e kandidatëve për Guvernatorë të Bankës Qendrore të Kosovës**
- 3. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për vitin 2010 i Radiotelevizionit të Kosovës;**
- 4. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për vitin 2010 i Agjencisë Kundër Korrupsionit;**
- 5. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për vitin 2010 i Autoriteti të Aviacionit Civil;**
- 6. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për vitin 2010 i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale;**
- 7. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për vitin 2010 i Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina;**
- 8. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja propozoi ta pika e gjashtë e rendit të ditës, të shqyrtohet si pika e dytë. Propozimi u përkrah njëzëri. Rendi i ditës u miratua me rirenditen e pikave të rendit të ditës.

2. Shqyrtimin e propozimit të Panelit të Bordit të Bankës Qendrore për zgjedhjen e kandidatëve për Guvernatorë të Bankës Qendrore të Kosovës

Kryetarja, prezantoi shkurtimisht procedurën e zhvilluar nga Paneli i Bordit të BQK-së, i cili në bazë të nenit 38.2 të Ligjit të BQK-së, ka zhvilluar procedurat e konkursit, selektimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e Guvernatorit. Pas kryerjes së procedurave janë përzgjedhur tre kandidatë të cilët i kanë plotësuar kushtet formalo-juridike. Më pas Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar në bazë të autoritetit të vet të specifikuar në nenin 2.2 d Aneksi IX për Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, në shprehjen e pëlqimit të tij, ka konstatuar se kandidati i propozuar, z. Gazmend Luboteni, është i papërshtatshëm për tu emëruar Guvernator, pasi që në nenin 38.1, përcaktohet se asnjë anëtar i Bordit nuk mund të shërbejë më shumë se dhjetë vjet në Bordet përkatëse të Bankës Qendrore. Si rezultat lista është reduktuar në dy kandidatë, të cilët iu janë dërguar Kuvendit dhe Qeverisë, e cila nuk ka sjellur në Kuvend ndonjë mendim për kandidatët e propozuar në afatin e paraparë siq parashihet me ligj. Nga CV-të e bashkangjitura shifet se kandidatët e propozuar, z. Gani Gërguri dhe z. Safet Merovci, i plotësojnë kushtet formale-juridike të parapara në nenin 40 të Ligjit të BQK-së

Naser Osmani, me që kemi dy kandidatë të propozuar për Guvernator, theksoi se ky komision duhet të nxjerr rekomandim Kuvendit për të dy kandidatët, në mënyrë që deputetët të vendosin, pasi që ne nuk kemi të drejtë të favorizojmë ndonjërin prej këtyre dy kandidatëve, por kjo punë i takon deputetëve ta zgjedhin Guvernatorin e BQK-së, në seancën plenare.

Albana Fetoshi, theksoi se në bazë të materialit, shifet se Pieter Feith e paska bërë zgjedhjen dhe shtroi pyetjen pse Pieter Feith duhet të na e zgjedhë Guvernatorin e BQK-së?

Kryetarja, si përgjigje e parafolësës, theksoi se në bazë të nenit 2.2 pika d Aneksi IX për Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, parashihet mundësia që Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar të shpreh pëlqimin për Guvernatorin, të cilin edhe e ka bërë.

Muhamet Mustafa, pyeti kryetaren se cili është roli ynë si komision lidhur me këtë çështje?

Kryetarja, në përgjigje të z. Mustafa, theksoi se ne si komision duhet të analizojmë se si ka shkuar procedura e në panelin e BQK-së, nëse ka nevojë të kërkojmë dhe informata shtesë. Si dhe të analizojmë se a i plotësojnë kushtet ligjore kandidatët e propozuar dhe ti rekomandojmë Kuvendit.

Muhamet Mustafa, sado që i vlerësoi të dy kandidatët për të arriturat e tyre profesionale, ai theksoi që këta kandidatë kanë mangësi në fushën e rregullimit makroekonomik, dhe për këtë qëllim ka kandidat më të përgatitur në këtë fushë.

Xhevdet Neziraj, po ashtu theksoi se paneli në bazë të Ligjit, e ka bërë vlerësimin e kandidatëve dhe tani Kuvendi pret nga komisioni një rekomandim për këtë çështje, pasi që komisioni nuk ka të drejtë të propozojë edhe një kandidatë tjetër, sepse ajo punë i ka takuar panelit.

Kryetarja, me që dy kandidatë e propozuar i plotësojnë kushtet ligjore të parapara në nenin 40 për të zgjedhur Guvernatori, propozojë që Komisioni ti rekomandojë Kuvendit që të përzgjedh njërin prej tyre dhe më pas kandidatit i përzgjedhur nga Kuvendit, ti dërgohet Presidentes për miratim dhe emërim.

Pas diskutimeve, Komisioni me tetë vota Për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Hasime Krasniqi, Duda Balje), dy kundër (Albana Fetoshi dhe Muhamet Mustafa) dhe një abstenim (Xhevdet Neziraj), nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Kandidatët e propozuar nga Paneli i Bordit të Bankës Qendrore për pozitën e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, z. Gani Gërguri dhe z. Safet Merovci, i përmbushin kriteret formalo-juridike të parapara me nenin 40 të Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, për t'u zgjedhur Guvernator të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
2. I rekomandon Kuvendit, të përzgjedhë njërin prej tyre, si kandidatë për pozitën e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
3. Kandidati i përzgjedhur nga Kuvendi, në bazë të nenit 38.2 të Ligjit nr.03/L-209 të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, t'i përcillet Presidentes për miratim dhe emërim në pozitën e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për vitin 2010 i Radiotelevizionit të Kosovës

Kryetarja, theksoi që raporti vjetor financiar i RTK-së nuk është edhe aq i standardizuar siç e kërkon Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive. Me nenin 33 të Ligjit për RTK-në, RTK-ja i raporton Kuvendit në baza periodike dhe vjetore në harmoni procedurat e përcaktuara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive, ndërkaq RTK-ja nuk ka raportuar në baza tre mujore.

Rahman Paçarizi, tregoi për problemet që është ballafaquar RTK-ja në financimin e aktiviteteve të saja, si rezultat i mos përcaktimit të mënyrës së financimit të RTK-ës me ligj. Në këtë vit RTK-ja për herë të parë ka dalë me një bilanc me shpenzime më të vogla si dhe nga shuma e marrë nga buxheti i Kosovës dhe marketingu ka arritur të paguajë borxhet e vitit 2009 dhe të ndajë rrogat e janarit për vitin 2011. Ka pasur rritje të shpenzimeve programore për shkak të udhëtimeve të ekipeve të gazetarëve jashtë vendit. Njoftoi se ka ndërmarrë disa veprime për të racionalizuar shpenzimet dhe menaxhimin e financave brenda saj duke miratuar disa rregullore që do të ndikojnë në menaxhimin më të mirë të financave, para së gjithash në raport me marketingun. Po ashtu edhe një veprim tjetër që është ndërmarrë nga RTK-ja është edhe përmbushja e një kriteri ligjor që ka të bëjë me 20 % e produkteve nga jashtë që ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve programore.

Muhamet Mustafa, kërkoi informata më të hollësishme për iniciativat e burimeve të përhershme të financimit që do ta rrisin pavarësinë editoriale RTK-së, pyeti se cilat janë shanset që në një të ardhme të afërt të gjenden burimet e përhershme të financimit?

Kryetarja, njoftoi se Ligji për RTK-në është pjesë e strategjisë legjislative në këtë mandat dhe së shpejti do të jetë objekt shqyrtimi, ku komisioni do të japë kontributin e tij për gjetjen e një mënyre tjetër të financimit.

Naser Osmani, theksoi se situata e problemeve të financimit të RTK-së, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për jo ligjshmërinë e financimit të këtij mediumi përmes parapagimit në faktuarat e KEK-ut. Situata edhe më rënduar kur Qeveria ka ndarë mjete për RTK-në me kusht që t'i raportojë Kuvendit, por kjo nuk ka ndodhë, sepse asnjëherë nuk kemi pasur një pasqyrë të planifikuar të shpenzimeve. Sa i përket raportit, sipas tij ky raport nuk i përmbahet standardeve të raportimeve financiare. Ai pyeti se a e ka RTK-ja të evidentuar pasurinë e saj të patundshme, a ka pasuri që jep me qira dhe pse këto nuk figurojnë, si dhe pyeti çfarë lloj reklame bëhet në RTK?

Sylejman Shaqiri, njoftoi se raportin e vitit e kaluar e kanë dërguar në Ministrinë e Financave dhe mund të diskutohet arsyeja pse ai raport nuk ka ardhur deri në Kuvend. Pasqyra e planit të shpenzimeve për vitin 2011 është dërguar aty ku edhe është sajuar buxheti, por nuk është plotësuar kërkesa, pasi që RTK-ja ka kërkuar 12 milion €, ndërsa i janë ndarë vetëm 7 milion e 900 mijë € për vitin 2011. Sa i përket çështjes së pronës, ai sqaroi se RTK-ja nuk ka pronë të veten, pronare e pasurisë të cilat i shfrytëzon RTK-ja është AKP-ja. Kjo pasuri u është dhënë atyre qysh në kohën e UNMIK-ut, ndërsa në draftin e Ligjit të ri propozohet që RTK-ja të shpallet trashëguese e pronës së RTP-së. Mjetet nga qiraja kanë të bëjnë me disa zyre në ndërtesën e Radios që shfrytëzohen dhe mjete që vijnë nga parkingu. Gjithashtu është themeluar shërbimi i marketingut përbrenda RTK-së dhe RTK-ja ndodhet në fazën e tejkalimit të atyre kontratave të marketingut që kanë të bëjnë me kompenzime.

Sali Asllanaj, pyeti pse marketingu ka pasur rënie, pse ka mbetur suficiti dhe a t'u mjaftojnë mjetet buxhetore të ndarë për këtë vit?

Duda Balje, pyeti se sa janë të hyrat vetanake që i realizon RTK-ja, përfshirë edhe ato të marketingut?

Rrahman Paçarizi, çështja e suficitit në tre muajt e vitit 2009, RTK-ja ka qenë pa kurrfarë financimi ku janë shkaktuar borxhe e të cilat borxhe pastaj është dashur të mbulohen në vitin 2010 gjë që i ka detyruar të bëjnë kursime të shumta që njëkohësisht janë bërë kursime edhe për fillimin e vitit 2010. Sa i përket çështjes së rënies së marketingut, ai sqaroi se në vitin 2009 kanë qenë zgjedhjet lokale të cilat sjellin shumë marketing, ndërsa në zgjedhjet e fundit fushata ka qenë më e shkurtër. Për mjetet e ndara për këtë vit, nuk janë të mjaftueshme, por shpresojnë që me realizimin e të hyrave nga marketingu do të mbulohen, gjithashtu edhe nëpërmjet kursimit në pozicione të caktuara. Të hyrat nga marketingu vitin e kaluar kanë qenë 14 % dhe për momentin RTK-ja mund të sigurojë 15-16 % të të hyrave nga të hyrat vetanake. Lidhur me këtë çështje u përmend edhe procesi i digjitalizimit i cili nëse realizohet do të jetë një kthesë e madhe për RTK-në duke siguruar të hyra vetanake, pa e ngarkuar direkt as qytetarin.

Kryetarja, kërkoi nga përfaqësuesit e RTK-ës, që sa më shpejt të dërgohet plani i detalizuar i të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2011, edhe pse buxheti është ndarë, por ekzekutimi mund të bëhet vetëm në bazë të një plani i cili duhet të dërgohet në Kuvend, konkretisht në Komisionin për Buxhet dhe Financa që të shqyrtohet. Propozojë që të miratohet raporti financiar.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. I rekomandohet Kuvendit, të miratojë raporti vjetor financiar për vitin 2010 i Radiotelevizionit të Kosovës.

2. Obligohet RTK-së, të dorëzojë planin e të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2011, për shqyrtim në Komision për Buxhet dhe Financa.

4. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Agjencisë Kundër Korrupsionit për viti 2010

Kryetarja, theksoi se nga raporti shifet se janë paraqitur shpenzimet, por nuk janë të detalizuara sa duhet shpenzimet për kategoritë ekonomike, si dhe mungon krahasimi i shpenzimeve me vitin 2009.

Hasan Preteni, në arsyetimin e raportit, theksoi se vitin e kaluar kësaj agjencie i janë lejuar 504 mijë 338 €, ndërsa buxheti është shpenzuar në vlerë prej 427 mijë e 050 €. Shpenzime më të vogla janë bërë në shpenzime komunale dhe në mallra e shërbime. Ai sqaroi se tabela e specifikuar e shpenzimeve nuk është futur në këtë raport, për shkak se raporti është publikuar në Web faqen e AKK-së, duke konsideruar që këtë tabelë duhet ta ketë vetëm Kuvendi.

Kryetarja, sugjeroi që në përgatitje të raporteve financiare të ketë krahasime me vitin paraprak si dhe të bashkangjitet rrjedha e shpenzimeve më të detalizuara. Raporti i plotëson të gjitha kushtet e përgjithshme formale të parapara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe propozoj që Komisioni ti rekomandoj Kuvendit për miratim.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. I rekomandohet Kuvendit, të miratojë raportin vjetor financiar për vitin 2010 i Agjencisë Kundër Korrupsionit

5. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për vitin 2010 i Autoriteti të Aviacionit Civil

U shtye për në mbledhjen e radhës së Komisionit

6. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për vitin 2010 i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

Kryetarja, shkurtimisht prezantoi raportin e shpenzimeve të KPMM-së për vitin 2011.

Ahmet Tmava, tregoi që ka qenë një mobilizim i shtuar në kuadër të KPMM-së që ka reflektuar rritje të të hyrave 100 %, dhe shkurtimisht prezantoi raportin që e kishin dorëzuar në Kuvend.

Naser Osmani, si rezultat i veprimit të operatorëve ilegalë të gurëthyesve, është dëmtuar e buxheti, sepse më tepër ka operatorë ilegal, se sa legal. Pyeti se cila është përgjegjësia e KPMM-së në këtë drejtim dhe pse nuk inicioni për t'i bërë 2-5 qendra për ta shpëtuar Kosovën që po shkon në degradim total?

Ahmet Tmava, tha që të gjithë operatorët ilegalë që veprojnë në Kosovë janë proceduar në prokurori dhe që infrastruktura ligjore është duke u kompletuar. Aktivizimi i Agjencionit për Menaxhimin e Mallit të Konfiskuar në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë do të jetë garancë e ç'rrenjosjes së operatorëve ilegalë.

Muhamet Mustafa, kërkoi një sqarim për rentat minerare ku janë faturuar 5 milion €, ndërsa janë inkasuar 8.2 milion € dhe pyeti sa paguhet tantiema në Kosovë, ku paguhet dhe ku shpenzohet?

Hykmete Bajrami, po ashtu kërkoi sqarim për rentat minerare ku janë inkasuar 8.2 milion €, ndërsa bilanci është negativ. Gjithashtu theksoi se do të ishte mirë të kemi një pasqyrë më të detalizuar për pagat e personelit, për mallrat dhe shërbimet.

Ahmet Tmava, lidhur me rentën minerare sqaroi renta minerare është kompetencë e Ministrisë së Financave, ndërsa KPMM-ja e bën mbikëqyrjen dhe grumbullimin e të hyrave.

Azem Rexhaj, tregoi se që inkasimi i rentës minerare është bërë edhe për vitet paraprake dhe për këtë arsye ekziston një disbalanc në mes të inkasimit dhe faturimit. Sa i përket mospërfshirjes së tantiemës është bërë një lëshim, sepse ata kanë paraqitur se do të ketë rritje të të hyrave të tantiemës edhe për vitin 2011. Ai tha që në Ligjin e Minierave është paraparë si rentë minerare dhe mund të jetë e përfshirë me termin rentë minerare. Me Ligjin për Miniera dhe Minerale është specifikuar qartë që mjetet e grumbulluara nga KPMM-ja depozitohen 100 % në buxhetin e Kosovës si para publike përmes xhirollogarisë së hapur në emër të KPMM-së, sepse nuk ka të drejtë t'i shfrytëzojë ato.

Kryetarja, kërkoi që Komisionit ti dërgohet një listë borxheve paraprake, për të parë se për çka janë përdorur mjetet për subvencione, si dhe kërkoi arsyetimin e rritjes së mallrave dhe shërbimeve.

Azem Rexhaj, tregoi që mjetet për subvencione janë shpenzuar për shujtat e stafit, pasi që vendimi i Qeverisë nuk e ka specifikuar se prej cilit pozicion mund të ndahen mjetet për shujta, ndërsa rritjen e mallrave dhe shërbimeve e arsyetoi me rritjen e çmimeve të karburanteve dhe rritjen e aktiviteteve në teren. Sa i përket tabelës së borxheve është e gatshme dhe do t'i përcillet komisionit.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. I rekomandohet Kuvendit, të miratojë raportin vjetor financiar për vitin 2010 i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

7. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për vitin 2010 i Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

Kryetarja, shkurtimisht prezantoi raportin e shpenzimeve nëpër kategoritë e caktuara, i cili i është dërguar Kuvendit edhe me shkrim.

Raif Preteni, tregoi ZRRUM-i vitin fiskal 2010 e ka filluar me një buxhet në vlerë prej 34 mijë e 450 €, ndërsa gjatë pjesës së parë të vitit ka pasur shkurtime buxhetor në vlerë prej 5 mijë e 768 € në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve që janë transferuar në kategorinë e pagave dhe mëdijtjeve. Gjithashtu i prezantoi shkurtimisht të gjitha kategoritë e raportit, i cili i është sjellur edhe Kuvendit.

Kryetarja, kërkoi një sqarim rreth gjobës që është paraparë me nenin 32.2, që specifikohet obligimi i shqiptimit të gjobave të kompanive që nuk i përmbushin obligimet ligjore.

Raif Preteni, sqaroi se për herë të parë në vitin e kaluar kanë filluar masat sanksionuese të parapara me ligj. Ai tha që presin nga Kuvendi të caktojë një anëtarë të komisionit për shqyrtimin e vendimeve të Rregullatorit.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. I rekomandohet Kuvendit, të miratojë raporti vjetor financiar për vitin 2010 i Zyrës Rregullatorit për Ujësjiellës dhe Mbeturina.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete HADERGJONAJ